

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA

Nr./Br. 01/2967/20

Nr. i fq./Br. str. _____

Data/Datum: 15.10.2020

PRISHTINË-PRISHTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 ADRESA: PRISHTINE, RRETHI I PRISHTINES, RRETHI I PRISHTINES
 10000 PRISHTINE

Udhë: _____ Nr. i follet: _____
 Dshp: Z-D Dshp: 01/22.11/20
 Nr. i faq. _____ Dshp: _____
 Broj. stranic: 04 Datum: 15.10.2020
 Nr. pages _____

PRISHTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO



AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS
 KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA
 KOSOVO KADASTRAL AGENCY



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIEJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

NË MES TË

AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

DHE

AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Prishtinë, Tetor 2020

Palët e këtij Memorandumi për Bashkëpunim, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Agjencia Kundër Korrupsionit, nënshkruajnë këtë Memorandum në bazë të kompetencave të tyre sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi. Agjencia Kadastrale e Kosovës nënshkruan këtë Memorandum Bashkëpunimi në bazë të nenit 4, të Ligjit Nr.04/-L-013 për Kadastër, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës. Ndërsa, Agjencia Kundër Korrupsionit nënshkruan këtë Memorandum Bashkëpunimi në bazë të nenit 5 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Neni 1

Qëllimi i Bashkëpunimit

1. Ky memorandum ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit në mes palëve nënshkruese për qasjen në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e më tejme si "RDPP") përmes ueb shërbimeve për përdorimin e të dhënave si të përcaktuara në këtë Memorandum.
2. Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Agjencia Kundër Korrupsionit do të krijojnë Procedura Standarde të Operimit për ofrimin e shërbimeve ku edhe do të definohet lloji i shërbimeve në nivelin teknik.

Neni 2

Përdorimi i të dhënave

1. Agjencia Kadastrale e Kosovës përmes këtij Memorandumi vë në dispozicion të dhënat që posedon sipas bashkëpunimit të përcaktuar me këtë Memorandum dhe sipas legjislacionit në fuqi.
2. Agjencia Kadastrale e Kosovës lejon që përdorimi i të dhënave nga Agjencia Kundër Korrupsionit të mundësohet në nivel leximi dhe printimi përmes ueb shërbimit, i cili është qasshëm vetëm nga përdorues të autorizuar, me mundësi kërkimi për njësi kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës) dhe për person.
3. Të dhënat e ofruara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për Agjencinë Kundër Korrupsionit janë konfidenciale dhe se përdorimi i tyre nga Agjencia Kundër Korrupsionit bëhet vetëm për qëllime të kësaj marrëveshje dhe përmbushjes së obligimeve sipas legjislacionit në fuqi, në fushat që lidhen me fushëveprimtarinë dhe kompetencat e Agjencisë Kundër Korrupsionit siç janë: hetimi dhe parandalimi i korrupsionit, prejardhja dhe kontrolli i pasurisë dhe të dhuratave, parandalimi i konfliktit të interesit, mbrojtja e sinjalizuesve, si dhe parandalimi i korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik.
4. Përdorimi i këtyre të dhënave për qëllime tjera konsiderohet si keqpërdorim dhe si i tillë do të sanksionohet sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Neni 3

Detyrimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës

1. Për qëllimet e zbatimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, Agjencia Kadastrale e Kosovës:
 - 1.1. Siguron qasje për të gjithë personat e autorizuar, për lexim dhe printim të informatave në RDPP, bazuar në nenin 24 dhe 26, të Ligjit Nr.04/-L-013 për Kadastër, nenit 17, paragrafi 1 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës;
 - 1.2. Ofron të dhënat nga RDPP përmes ueb shërbimeve duke shfrytëzuar bazën elektronike të sistemeve digjitale;
 - 1.3. Cakton një zyrtar, i cili do të jetë pikë kontakti mes palëve nënshkruese të këtij memorandumi;
 - 1.4. Ofron trajnim për zyrtarët të cilët do të kenë qasje në RDPP përmes ueb shërbimeve;
 - 1.5. Nxjerrë raporte për shërbimet e dhëna (javore, mujore, vjetore) sipas kërkesës;
 - 1.6. Harton dokumentin “Marrëveshja e nivelit të shërbimit” si udhëzues për mënyrën e përdorimit të ueb shërbimeve si dhe llojet e shërbimeve që do të ofrohen;
 - 1.7. Siguron që të dhënat që i ofron do të jenë të përditësuara dhe të qasshme në çdo kohë.

Neni 4

Detyrimet e Agjencisë Kundër Korrupsionit

1. Për qëllimet e zbatimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, Agjencia Kundër Korrupsionit:
 - 1.1. Ofron në dispozicion të Agjencisë Kadastrale të Kosovës listën e personave të autorizuar të cilët do të kenë qasje në RDPP përmes ueb shërbimeve;
 - 1.2. Kryen përgatitjet teknike të nevojshme për qasje në RDPP përmes ueb shërbimit;
 - 1.3. Cakton një zyrtar kontaktues sa i përket kërkesave për hapjen/mbylljen e llogarive të përdoruesve, mbikëqyrjen e sigurisë dhe çështjeve tjera të lidhura me qasjen dhe përdorimin e të dhënave përmes ueb shërbimeve nga RDPP.
2. Personi i autorizuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit obligohet të ruaj fshehtësinë dhe të mbajë të sigurtat të dhënat e marra-shikuara nga RDPP dhe obligohet që të mbajë evidencën e raporteve të punës në sistemin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Neni 5

Kushtet Financiare

Zbatimi i këtij Memorandumi nuk krijon obligime financiare për palët. Sidoqoftë, në rast të shpenzimeve eventuale, secili institucion, në mënyrë të pavarur, do të mbulojë koston financiare për realizimin e këtij Memorandumi për Bashkëpunim, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ndonjë dispozitë të veçantë.

Neni 6 Zbatimi

1. Palët pajtohen se do të kujdesën për zbatimin me përkushtim dhe përpikëri të kësaj marrëveshje.
2. Modalitetet e ofrimit të të dhënave do të përcaktohen më në detaje në mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, përmes grupeve teknike të themeluara në mes të dy institucioneve, duke marrë parasysh kërkesat e të dy palëve për sigurinë e parandalimit të keqpërdorimit të të dhënave.

Neni 7 Dispozitat përfundimtare

1. Ky Memorandum mund të plotësohet dhe të ndryshohet në çdo kohë me pajtimin e palëve nënshkruese përmes një njoftimi paraprak me shkrim.
2. Bashkëpunimi sipas këtij memorandumi do të bëhet përmes formave të rregullta të komunikimit zyrtar ndërinstitucional. Palët zotohen se do të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë memorandum ashtu siç parashihet. Mosmarrëveshjet eventuale zgjidhen me mirëkuptim.
3. Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë nga të dyja palët, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.

Neni 8 Hyrja në fuqi dhe nënshkrimi

1. Ky Memorandum për Bashkëpunim nënshkruhet për një kohë të pacaktuar, ndërsa hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
2. Memorandumi i Bashkëpunimit është i përgatitur në gjuhën shqipe, në 2 (dy) kopje origjinale, nga 1 (një) kopje origjinale për secilën palë.

Data dhe vendi i nënshkrimit të këtij Memorandumi për Bashkëpunim:

Prishtinë, __, __, 2020 [dita-muaji-viti]

Në emër të:



Në emër të:

Agjencisë Kundër Korrupsionit

z. Shaip HAVOLLI

